Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti të mbledhjes së 273-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit i mbledhjes së 274-t Elektronike/Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.

2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Metodologjinë e Monitorimit, Raportimit të Emetimeve të Gazeve Serrë dhe Informacione të Tjera në Lidhje me Ndryshimet Klimatike në Nivel Kombëtar.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit, për prodhimin e energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK, Sh. A.), zonat kadastrale Siboc, Shipitullë, Leshkoshiq, Hade dhe Palaj, Komuna e Obiliqit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK, Sh. A.)

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M  P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore që administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), për nevoja të Institucioneve të Republikës së Kosovës, Zona Kadastrale Beroc II, Komuna Shtërpc, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i Qendrës për Sport dhe Kulturë në Komunën e Ferizajt, Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna e Ferizajt, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Nr. 07/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Rehabilitimi, Zgjerimi dhe Asfaltimi i Rrugës Nacionale R118, Segmenti Brenda Fshatit Mushtisht, Zona Kadastrale Mushtisht, Komuna e Suharekës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9,10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M  P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i Rrugës Korishë - Kabash - Lidhja me Rrugën Rajonale R - 118, zonat kadastrale: Lubizhdë, Skorobishtë, Korishë, Kabash, Komuna e Prizrenit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

### V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Gjakovës:

    - Administrimi i objektit të "ish Bankos-it" për nevoja të administratës së Komunës së Gjakovës, Zona Kadastrale, Gjakovë-Qytet, Komuna e Gjakovës; dhe
    - Ndërtimi i Fushës së Futbollit dhe hapësirave rekreative për fshatin Trakaniq dhe fshatrat rreth zonës Trakaniq, Zona Kadastrale Trakaniq.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Gjakovës.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore për nevoja të Agjencisë së Shërbimeve të Navigaconit Ajror (AShNA), Zona Kadastrale Vrellë e Goleshit, Komuna e Lipjanit, Zona Kadastrale Zatriq, Komuna e Rahovecit, Zona Kadastrale Mramor, Komuna e Prishtinës dhe Zona Kadastrale Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues (AShNA).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 23,472.00€ (njëzetetremijë e katërqindeshtatëdhjetedy euro) për mbështetjen e FCF Prishtina 01 - Futsall për organizimin e Uefa Champions League, me datën 24 nëntor 2025 në Prishtinë dhe me datën 5 dhjetor 2025 në Riga të Letonisë, më qëllim të promovimit të vendit.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogarinë e përcaktuar nga subjekti përfitues.

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 25,925.00€ (njëzetepesë mijë e nëntëqindenjëzetepesë euro), për pjesëmarrjen e Ekipit të Kosovës në NEO Science Olympiad - Orlando 2025, më qëllim të promovimit të vendit.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogarinë e përcaktuar nga subjekti përfitues.

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 13/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 850,000€ (tetëqindepesëdhjetë mijë euro), për mbulimin e mungesës së mjeteve në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa" për muajin nëntor 2025, për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201 nga nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa", dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me kod 214, në nënprogramin "Shërbimet Administrative" me kod 30000, në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore KBI Ereniku, për nevoja të realizimit të projektit: "Ndërtimi i Zonës Industriale të Mbrojtjes" Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafit 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 15/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Amendamentit Nr. 5 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2014".

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafëve 2, dhe 6, të nenit 7, dhe paragrafit 4, të nenit 10, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 16/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).

2. Obligohet Thesari që mjetet e ndara nga aneksi B (ndarjet), në kodin 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në shumë prej 4,480.000.00€ (katër milionë e katërqindetetëdhjetë mije euro), të transferoj në llogarinë bankare të përcaktuar nga Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në Bankën Komerciale.

3. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet )

| BLLOKU KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 10/250/33500/30/18566/0330 | KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES | PROKURORIA DHE ADMINISTRATA | 18566 | BLERJA E TOKES PER PTH MITROVICE | 500,000.00 |
| 10/104/31100/30/19300/0220 | ZYRA E KRYEMINISTRIT | KËSHILLI I SIGURISË SË KOSOVËS | 19300 | KRIJIMI I HAPSIRES PËR STRUKTURAT MBËSHTETS | 1,500,000.00 |
| 10/215/33600/30/19334/0340 | MINISTRIA E DREJTËSISË | SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS | 19334 | ZGJERIMI I INSTITUTIT TE FORENZIKES | 661,886.00 |
| 10/216/11316/30/15173/0113 | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE | ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ | 15173 | SISTEMI I SIGURISË SË KOMUNIKIMIT PER MPJ DH | 875,000.00 |
| 10/205/43600/30/19145/0550 | MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HA | AGJENCIA KOSOVAR PËR MBROITJEN | 19145 | NDERTIMI I OBJEKTIT/NDERTESES SE RE TE IHMK-S | 250,000.00 |
| 10/205/60800/30/19282/0520 | MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HA | AUTORITETI RAJONAL I PELLGJEVE LU | 19282 | RREGULLIMI DHE REHABILITIMI I PELLGUT DRINI I E | 800,000.00 |
| 10/205/49600/30/19654/0640 | MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HA | DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË RR | 19654 | NDRIQIMIT SMART TE AUTOSTRADAVE - IMPLEME | 447,566.00 |
| 10/205/41600/30/19410/0443 | MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HA | REHABILITIMI I RRUGËVE | 19410 | REHABILITIMI I RRUGËS RAJONALE R116 DOGANAJ | 320,548.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-KURSIME INVESTIME KAPITALE | | | | | 5,355,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL -KURSIME | | | | | 5,355,000.00 |

Aneks B (Ndarjet)

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | SHUMA |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 10/216/14300/13/00000/0113 | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE D | AMBASADAT - MPJ | 13 | MALLERA DHE SHERBIME | 323,400.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-MALLRA DHE SHERBIME | | | | | 323,400.00 |
| | | | | | |
| 10/216/11316/20/00000/0113 | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE D | ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 551,600.00 |
| 10/201/11200/20/00000/0112 | MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TR | THESARI I KOSOVËS | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 4,480,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | | | | | 5,031,600.00 |
| | | | | | |
| | | | | | |
| TOTAL-NDARJE | | | | | 5,355,000.00 |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 17/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 300,000€ (treqind mijë euro) për organizimin e pjesëmarrjes së Kosovës në Forumin Ekonomik Botëror Davos, me Kosova House.

2. Mjete Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogarinë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara ('UNDP').

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 18/277
Datë: 27.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).

2. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).

3. Obligohet Thesari që mjetet e ndara nga aneksi B (Ndarjet), në kodin 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në shumë prej 250,000€ (dyqindepesëdhjetë mijë euro), të transferoj në llogarinë bankare që përcaktohet në komunikim me Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit.

4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet )

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| 10/205/41800/30/19410/0443 | MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HA | REHABILITIMI I RRUGËVE | 19410 | REHABILITIMI I RRUGËS RAJONALE R116 DOGANAJ | 250,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-KURSIME INVESTIME KAPITALE | | | | | 250,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL -KURSIME | | | | | 250,000.00 |

Aneks B (Ndarjet)

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | SHUMA |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 10/201/11200/20/00000/0112 | MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TR | THESARI I KOSOVËS | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 250,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | | | | | 250,000.00 |
| | | | | | |
| TOTAL-NDARJE | | | | | 250,000.00 |